Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
Nr/Br. 1134/20
Datë/Datum. 14.01.2021
PRISHTINË - PRIŠTINA

DATË/A:	**14 JANAR 2021**
REFERENCË:	**1134/20**
PËR/ZA/TO:	**AK- KRU "HIDROMORAVA"sh.a**
NGA/OD/FROM:	**Blerim Dina -Kryetar i – OSHP-së**
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	**NJOFTIM**

Operatori ekonomik: **K.N.T.SH."TEUTA-M"SH.P.K**, si palë e pakënaqur me datën: 23.12.2020, kanë parashtruar në OSHP ankesën me numër 1134/20 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Sanimi,menaxhimi dhe mirëmbajtja e sistemit te ujësjellësit në Lagjen Qameria, Kamenicë"** me nr. të prokurimit: **20-7882-5-2-1** me nr.te brendshme **KRU-2020-008-521**, duke pretenduar se AK ka shkelur këto dispozita ligjore:

- Neni 1, 7, 56.3, 60, 87 paragrafi 2 të LPP-së.
- Nenin 41. 3 dhe 18.1 , 18.2 te RRUOPP-së

Organi Shqyrtues i prokurimit, pas pranimit të anekses, në bazë të nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë 30 Dhjetor 2020 kanë autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Eksperti profesional i prokurimit me datën 11 Janar 2021 ka dorëzuar raportin e ekspertizës dhe ka konstatuar që ankesa e OE ankues **te pranohet si e bazuar dhe Vendimi i AK-së të anulohet**.

Autoriteti kontraktues- **KRU "HIDROMORAVA"sh.a** me datën 11 Janar 2021 kanë pranuar mendimin e ekspertit profesional të prokurimit dhe të njëjtit me datën 12 Janar 2021 përmes parashtresës me shkrim kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së se **PAJTOHEN** me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës.

Operatori ekonomik: **K.N.T.SH."TEUTA-M"SH.P.K** me datën 11 Janar 2021 kanë pranuar mendimin e ekspertit profesional dhe të njëjtit me datën 12 Janar 2021 përmes parashtresës me shkrim kanë njoftuar panelin shqyrtues të OSHP-së se **PAJTOHEN** me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues njofton operatorin ekonomik ankues dhe autoritetin kontraktues se konform nenit 115 pika 3 i LPP-së që procedura e ankesës përfundon në këtë fazë. Autoriteti kontraktues- **KRU "HIDROMORAVA"sh.a** për aktivitetin e prokurimit me titull : **"Sanimi,menaxhimi dhe mirëmbajtja e sistemit te ujësjellësit në Lagjen Qameria, Kamenicë"** me nr. të prokurimit: **20-7882-5-2-1**me nr.te brendshme **KRU-2020-008-521**, dhe njëkohësisht kanë konstatuar se duhet të **pranohet si e bazuar dhe Vendimi i AK-së të anulohet**, konform mendimit te dhënë ne raportin e ekspertizës.

Paneli shqyrtues obligon autoritetin kontraktues që në afat prej dhjetë (10) ditësh ta njoftojë me shkrim panelin shqyrtues lidhur me të gjitha veprimet e ndërmarra për këtë aktivitet të prokurimit.

Operatori ekonomik: **K.N.T.SH."TEUTA-M"SH.P.K** konform nenit 118 pika 3 të LPP-së i kthehet sigurimi i ankesës. Urdhërohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.